



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E LEGJISLACIONIT
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Fier më, 28.10.2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: **“Furnizim vendosje parketi profesional sportiv në Pallatin e Sportit të lojrave me dorë”,**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

44112240-2 “Parket”;

45432113-9 “Shtrim i dyshemesë me parket”.

VLERA E FONDIT LIMIT: 9 620 167 (nëntë milion e gjashtëqind e njëzet mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) **lekë pa TVSH.**

Shënim: Në bazë të shkresës nr.5966/1 prot. datë 07.07.2022 të Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, për financimin dhe fillimin e procedurave të prokurimit publik me objekt “Furnizim vendosje parketi në Pallatin e Sportit të lojrave me dorë”, objekti i prokurimit do të kontraktohet dhe zbatohet me vlerë të plotë, por për vitin 2022 do të financohet në vlerën prej **10 000 000 (dhjetë milion) lekë me TVSH**, ndërsa pjesa tjetër e mbetur e kontratës do të financohet në vitin buxhetorë 2023, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Fier ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës 8:

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në nenin 76 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, në të cilën është e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas percaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (2020, 2021) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se **3 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 ”Per Prokurimin Publik”, në të cilin gjejmë të percaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që

garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; ne piken 1 dhe piken 2/c të nenit 43 të VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, ku përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mesipër është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/b e nenit 43 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, perkatesisht; Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar; Duke qene se kjo procedure prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit nën kufirin e ulët monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara me pare gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenin 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar të nevojshme përcaktimin e dy viteve të fundit në përputhje me vlerën e fondit limit të parashikuar.*

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit. Ne kete rast vlera e kerkuar eshte jo me pak se **1 900 000 lekë pa TVSH** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Per kete pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese një nga dokumentat e meposhtem:

- a-** vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

ose

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 4 dhe nenit 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo me pak se **1 900 000 leke pa TVSH** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet) që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, piken 4 te nenit 40 dhe piken 4/b te nenit 55 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e ketij kriteri behet me qellim qe Autoriteti Kontraktor te sigurohet per aftesine teknike te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet pervojës se meparshme, se zoterojne kapacitet dhe aftesine teknike per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e kontratës.

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se dispononë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

- Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

NS – 4 A (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikat 2 të nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të pikës 5/a të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Kategoria e kërkuar është bazuar sipas preventivit të pjesë të DST.

2.3.3 Staf i kryesor dhe mbështetës, punonjësit, certifikimet, kualifikimet për ekzekutimin e kontratës.

- a)** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierin e mëposhtëm:

- 1.** Inxhinier ndërtimi - 1 (një).

Inxhinieri i mesipër duhet të figurojë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën periudhën **Shtator 2022**. Për inxhinierin duhet të paraqitet: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme).

- b)** Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij ose me kontratë pune të vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës :

- 1 (një) përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë, i cili të jetë i certifikuar me certifikatë/dëshmi si: “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit nr.10327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

c) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij në listepagesën e shoqërisë për **muajin Shtator 2022 ose** me kontratë pune të vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës, specialistë të certifikuar sipas profesioneve, të pakten si më poshtë:

- Specialistë të certifikuar/trajnuar për instalime të strukturave të drurit - 2 (dy).
- Punonjes marangoze me diplome/certifikate të leshuar nga një organizatë certifikimi e licensuar/akredituar shqiptare ose e huaj - 2 (dy).

Për specialistet e sipercituar në pikën “c” duhet të paraqesin:

1. Dëshmi/certifikate ose cdo dokument tjetër që verteton diplomimin apo kualifikimin e tyre, leshuar nga një organizatë certifikimi e licensuar/akredituar shqiptar ose i huaj.
2. Kontrata individuale e punës e vlefshme për të pakten periudhën e parashikuar të ekzekutimit të kontratës.
3. Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (*te vlefshme*), leshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara në Republikën e Shqipërisë për certifikimin e punonjesve.

Shënim: Për pikat **a)**, **b)** dhe **c)** të pikës **2.3.3** me sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në shkronjat **a)**, **b)** dhe **c)** të pikës **2.3.3**, si më sipër kërkuar. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Autoriteti Kontraktor (njesia e prokurimit) ka kërkuar paraqitjen e listepageses së muajit Korrik 2022 për arsye se është muaji i fundit i maturuar duke u nisur nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Bazuar në ligjin nr.9136 datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*Neni 11 Afatet e deklarimit dhe te pagesës*), operatorët ekonomikë kane afat të shlyejnë detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore brenda datës 20 të muajit pasardhës.

2.3.4 Operatori Ekonomik Ofertues duhet te ketë fuqi minimale punetore te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit, me nje numer prej jo me pak se **7 (shtatë) punonjës,** për **muajin Shtator 2022.**

Shënim: Për pikën **2.3.4** më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.4**, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

- a)** Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve, për **muajin Shtator 2022.**
- b)** Listë pagesat e punonjësve, sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, për **muajin Shtator 2022.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, në K.Punës, legjislacionin për sigurimet shoqërore (pushimet, leje e zakonshme), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Autoriteti Kontraktor (njesia e prokurimit) ka kerkuar paraqitjen e listepageses se muajit Korrik 2022 per arsye se eshte muaji i fundit i maturuar duke u nisur nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates. Bazuar ne ligjin nr.9136 date 11.09.2003 “Per mbledhjen e kontributeve te detyrueshme te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar (*Neni 11 Afatet e deklarimit dhe te pagesës*), operatoret ekonomike kane afat te shlyejne detyrimet per sigurimet shoqerore e shendetesore brenda dates 20 te muajit pasardhes.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat sipas standardeve:

- ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent;

e vlefshme, per objektin qe prokurohet (*te cilat duhet te jene te perkthyer ne gjuhën shqipe dhe te noterizuara*), të lëshuar nga Organizmat e Vleresimit të Konformitetit, te cilat jane te akredituara nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga Organizmat Nderkombetare Akreditues te njohura ne Republiken e Shqiperise.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020 ”Per Prokurimin Publik”, ne te cilen gjejme te percaktuar se: *1. Autoriteti ose enti*

kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter gjen mbështetje në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 "Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë".

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

a) Autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, për materialet **(binarë druri, parket druri, astar, membrane për pengesë të lageshtires)**.

Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, duhet të provohet edhe lidhja midis prodhuesit dhe distributorit.

Secili nga dokumentat e sipërcituar, duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit, si: tel., e-mail, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave, si dhe të jetë origjinale ose fotokopje e noterizuar e njehsuar me origjinalin, dhe nëse është në gjuhë të huaj, duhet të jetë e përkthyer në shqip dhe e noterizuar, sipas konfirmimit të noterit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikat 2 dhe 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe piken 5 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku është e cituar: 5. *Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afatëve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Duke iu referuar per analogji vendimeve te KPP-se dhe rekomandimeve te APP-se, Autoriteti Kontraktor ka gjykuar qe te paraqitet autorizim prodhuesi ose autorizim distributori per mallin objekt prokurimi.

Si dhe gjithashtu ky kriter u vendos ne mbeshtetje te Rekomandimit nr. 3341/1 prot. Date 20.03.2018 te Agjensise se Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve per kualifikim ne dokumentet e tenderit te procedurave te prokurimit publik".

b) Per materialet e kerkuara (**binarë druri, parket druri, astar, membrane per pengese te lageshtires**), te paraqiten katalog/et **ose** skedat teknike te prodhuesit/ve, ku te specifikohen materialet qe do te ofrohen, si dhe te paraqiten certificate/deklarate konfirmimit CE **ose** certifikatat e cilesise **ose** raportet e testimit nga laboratore te akredituar, me qellim permbushjen e standarteve te kerkuara ne pecifikimet teknike per keto materiale.

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu, si dhe te cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 4 pika 38/b, nenin 36 dhe 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik, si dhe me piken 6/b te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik"i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se:[...] 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:[...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].

Duke iu referuar per analogji vendimeve te KPP-se dhe rekomandimeve te APP-se, Autoriteti Kontraktor ka gjykuar qe te paraqitet katalog/et ose skedat teknike te prodhuesit/ve per mallin objekt prokurimi, pasi paraqitja e katalogjeve eshte kerkuar me qellim verifikimin e perputhshmerise se mallrave qe operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike te percaktuara ne DST.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe pajisjet teknike qe ka ne dispozicion, te cilat jane si me poshte:

a) Mjetet dhe pajisjet teknike te nevojshme per ekzekutimin e kontrates, si me poshte (*sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit, sipas shtojcës nr.8*):

| Nr. | Lloji i makinerive | Pronesia | Njesia | Sasia |
|-----|----------------------------------------------------------------------------------------|------------------------|--------|-------|
| 1 | Kamioncine me kapacitet mbajtes deri ne 1.5 ton (per transport materiale dhe makineri) | ne pronesi ose me qera | cope | 1 |
| 2 | Gjenerator (ne rast mungese te perkohshme energjie elektr.) | ne pronesi ose me qera | cope | 1 |

| | | | | |
|---|----------------------------------------------------------|------------------------|------|---|
| 3 | Sharrë (per prerje eventuale te materialit te drurit) | ne pronesi ose me qera | cope | 1 |
| 4 | Zmerilatrice (per zmerilim te siperfaqes se parketit) | ne pronesi ose me qera | cope | 1 |

b) Operatori ekonomik ofertues duhet te ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion, mjete dhe pajisje te mbrojtjes ne pune te punetoreve dhe personelit (pronesi ose me qera), te nevojshme per ekzekutimin e kontrates si me poshte (*sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit, sipas shtojcës nr.8*):

- Kokore, minimumi 5 cope.
- Fikese zjarri te levizshme me kapacitet 5-7 litra secili, minimumi 2 cope.
- Prozhektore ndricimi naten, minimumi 2 cope.
- Komplete te ndihmes se shpejte, minimumi 2 cope.

Shënim: Për pikën **2.3.7 (a dhe b)** si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.7 (a dhe b)**, duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit.

b) Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontraten perkatese noteriale të qerases, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.

c) Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

d) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij/tyre.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime

dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Gjithashtu, kërkesat për disponimin ose mundësinë e sigurt të disponimit të mjeteve apo kapaciteteve teknike të kërkuara në këto kërkesa për kualifikim, bazohet edhe në nevojën për mundësinë e sigurt të disponimit të mjeteve që AK kërkon nga OE, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, për të zbatuar kontratën, duke demonstruar kapacitet teknik si për mjetet që do të angazhohen në zbatimin e kontratës, ashtu edhe për kapacitet teknike që lidhen me gadishmerinë për plotësimin e tyre në rrethana të caktuara, duke pasur si synim zbatimin e në kohë dhe në cilësi të kontratës objekt prokurimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike dhe kriteret e vecanta të kualifikimit janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Fier, nr.3783 prot datë 06.05.2022, të cilët janë dhe pjesë e njesisë së prokurimit, në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

Specifikimet teknike dhe grafiku i punimeve gjenden bashkëngjitur DST në SPE.

NJESIA E PROKURIMIT :

